




Central Fiscal Authority  
**AUTORITETI QENDROR FISKAL**



**RREGULLAT E ADMINISTRATËS TATIMORE**  
**MBI IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/35**  
**‘MBI PENSIONET NË KOSOVË’**

Bashkë-Drejtorët e Administratës Tatimore, në përputhje me autorizimin dhënë atyre sipas Nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35, të datës 22 Dhjetor 2001, ‘Mbi Pensionet në Kosovë’

Me këtë shpallin,

Rregullat vijuese:

Neni 1  
Përkufizimet

Termi ‘Rregullore’ do të nënkuptojë Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 ‘Mbi Pensionet në Kosovë’.

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) është një institucion i pavarur i themeluar nga Rregullorja për qëllim të administrimit dhe menagjimit të llogarive individuale për kursimin e pensioneve.

Neni 2  
Kontributi i financimit të pensioneve të kursimeve individuale

Të dy si punëdhënësi ashtu edhe i punësuarit janë të obliguar të kontribuojnë në financimin e Pensioneve të Kursimeve Individuale. Kontributi obligativ përkatës do të jetë 5% të pagës bruto të të punësuarit nga i punësuarit dhe 5% nga punëdhënësi. Për shembull, nëse paga bruto (përpara zbritjeve të lejueshme) e një të punësuarit është 500 €muaj, kontributi i të punësuarit për Pensionet e Kursimeve Individuale do të jetë  $5\% \times 500 = 25$  €muaj. Punëdhënësi kërkohet të kontribuojë shumën e njëjtë. Kështu, në përgjithësi, kontributet që i punësuarit dhe punëdhënësi do të kryejnë për Pensionet e Kursimeve Individuale për një të punësuar i cili paguhet 500 €muaj do të jenë 50 €apo 10% e pagës bruto.

Neni 3  
Implikimet në Tatimin mbi të Ardhurat Personale

Për qëllime të Tatimit mbi të Ardhurat Personale kontributi obligativ i të punësuarit për Pensionet e Kursimeve Individuale është i zbritshëm nga paga bruto ndërsa kontributi i punëdhënësit nuk është. Në shembullin e dhënë më lartë, të ardhurat e tatueshme për atë të punësuar do të jenë  $500 \text{ €} - 25 \text{ €} = 475$  €muaj.

#### Neni 4

##### Kontributet vullnetare suplementare përveç përqindjes statutore nën mandat

Punëdhënësi dhe i punësuar lejohej vullnetarisht të kontribuojnë më tepër sesa shuma 5% e kërkuar e pagës bruto. Shuma maksimale e lejueshme vullnetare do të jetë 10% të pagës bruto për hisen e punëdhënësit dhe 10% të pagës bruto për hisen e të punësuarit. Kontributi i kombinuar i punëdhënësit dhe të punësuarit nuk mund të tejkalojë 30% të pagës bruto. Vetëm kontributi obligativ i të punësuarit (5%) është i zbritshëm nga paga bruto për qëllime të tatimit mbi të ardhurat.

#### Neni 5

##### Obligimi i punëdhënësit për të mbajtur në burim dhe paguar hisen e kontributeve të të punësuarit.

Secili punëdhënësi do të jetë i detyruar të mbajë në burim hisen e kontributeve të të punësuarit për Pensionet e Kursimeve Individuale në momentin kur pagat i paguhen të punësuarit. Punëdhënësi i shton shumës së mbajtur në burim hisen e tij/saj të kontributeve dhe shuma totale transferohet në llogarinë bankare të specifikuar nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës jo më vonë se në ditën e 15 të muajit që pason muajin në të cilin pagat janë paguar apo janë akruar. Nëse ajo ditë është pushim, pagesa do të jetë obligim në ditën e parë të punës që pason ditën e 15 të muajit.

Nëse punëdhënësi paguan pagat më shumë se një herë në muaj, do të kërkohet të bëhet vetëm një pagesë mujore për secilin të punësuar. Shuma e asaj pagese duhet të jetë e kalkuluar bazuar në shumën e të gjitha pagesave të pagës të kryera për të punësuarin gjatë atij muaji.

Nëse punëdhënësi gjendet se nuk është përmbushës i Rregullores në lidhje me pagesën nën mandat, punëdhënësi i tillë do t'i nënshtrohet obligimit të bëjë pagesat e nevojshme shtesë.

#### Neni 6

##### Librat dhe regjistrimet që duhet mbajtur nga Punëdhënësi

Për qëllime të Rregullores, secili punëdhënësi kërkohet të mbajë dhe të ruaj librat dhe regjistrimet e listuara më poshtë për një periudhë prej 5 viteve:

- Regjistri mujor i listës së pagave
- Përmbledhja tremujore e listës së pagave
- Kontributet dhe Libri Tatimor

Formulari vijues është model i regjistrimit mujor të listës së pagave:

## REGJISTRI MUJOR I LISTËS SË PAGAVE

Muaji \_\_\_\_\_ Viti \_\_\_\_\_

Faqe \_\_\_\_\_

| No      | Emri i të punësuarit | NP / NIT i UNMIK-ut | Pagat bruto | Kontributi i të punësuarit | Kontributi i punëdhënësit | Totali i kontributit | Kontributi shtesë i të punësuarit | Kontributi shtesë i punëdhënësit | Kontributi total i përputhur |
|---------|----------------------|---------------------|-------------|----------------------------|---------------------------|----------------------|-----------------------------------|----------------------------------|------------------------------|
| A       | B                    | C                   | D           | E=Përqindja x D            | F=Përq. x D               | G=E+F                | H                                 | I                                | J=G+H+I                      |
|         |                      |                     |             |                            |                           |                      |                                   |                                  |                              |
|         |                      |                     |             |                            |                           |                      |                                   |                                  |                              |
|         |                      |                     |             |                            |                           |                      |                                   |                                  |                              |
| Totali: | -                    | -                   |             |                            |                           |                      |                                   |                                  |                              |

“Pagat” nënkupton çdo shumë të paguar nga punëdhënësi, në para të gatshme (kesh) apo në natyrë, si kompensim për shërbimet të dhëna nga i punësuarit gjatë punësimit, pa marrë parasysh a është nën kontratën e punësimit me shkrim apo jo. Pagat përfshijnë rrogat, shpërblim, bonus, pagesë komisionere, apo çdo formë tjetër e pagesës që lidhet me punësimin.

Përqindja në secilën nga kolonat [E] dhe [F] mund të jetë deri në 15% por nuk mund të jetë më pak se 5%.

Në qoftë se, pas pagesës fillestare, kontributet shtesë për periudhën e njëjtë duhet të paguhet (si akt vullnetar apo si rezultat i kontrollit të mbrendshëm apo të jashtëm), ato kontribute duhet të regjistrohen në kolonat [H] dhe [I]. Kontributet suplementare në baza vullnetare mund të bëhen në mënyrë retroaktive por jo më vonë se dy muaj pas dorëzimit të pagesës origjinale mujore.

Regjistrimet Mujore të Listës së Pagave mund të përgatiten në mënyrë elektronike me kusht që ato të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara, - për shembull shfrytëzimi i software-ëve standard të shpërndarë nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (kërkoni nga [KPST@kpst.org](mailto:KPST@kpst.org)).

Pagesa mujore duhet të përfshijë kontributin total të të punësuarve dhe kontributin total të punëdhënësit. Shuma totale e kontributeve të të punësuarve dhe e kontributeve të punëdhënësit duhet të jetë e specifikuar në kutinë 12 dhe 13 të “Pasqyra e Kontributeve për Pension dhe Formulari i Dërgesës” (Neni 11 i këtij dokumenti).

Formulari vijues është model për Përmbledhjen Tremujore të Listës së Pagave:

## PËRMBLEDHJA TREMUJORE E LISTËS SË PAGAVE

Muaji \_\_\_\_\_ Viti \_\_\_\_\_

Faqe \_\_\_\_\_

| No      | Emri i të punësuarit | NP / NIT i UNMIK-ut | Totali i pagave bruto të paguara për tremujor | Kontributi i të punësuarit i mbajtur në burim për tremujor | Kontributi i punëdhënësit i paguar për tremujor | Kontributi total i mbajtur në burim dhe i paguar për tremujor |
|---------|----------------------|---------------------|---|--|---|---|
| A       | B                    | C                   | D   | E=Përqindja x D  | F=Përqind. x D                                  | G=E+F   |
|         |                      |                     |   |  |   |   |
|         |                      |                     |   |  |   |   |
|         |                      |                     |   |  |   |   |
| Totali: | -                    | -                   |   |  |   |   |

Përqindja në secilën prej kolonave [E] dhe [F] mund të jetë deri në 15% por nuk duhet të jetë më pak se 5%.

Totali i pagave bruto të paguara për tremujor për secilin të punësuar është shuma e të gjitha pagesave të pagave gjatë tremujorit, përfshirë të gjitha shtesat dhe përmirësimet. Kontributet e të punësuarit të mbajtura në burim për tremujor janë shuma e të gjitha kontributeve mujore të mbajtura në burim gjatë tremujorit duke përfshirë edhe kontributet shtesë të të punësuarit. Po kështu, kontributet e të punësuarit të paguara për tremujor janë shuma e të gjitha kontributeve mujore të bëra gjatë tremujorit për secilin të punësuar, duke përfshirë të gjitha kontributet shtesë të punëdhënësit.

Përmbledhjet Tremujore të Listës së Pagave mund të përgatiten në mënyrë elektronike me kusht që ato të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara, - për shembull shfrytëzimi i software-ëve standard të shpërndarë nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (kërkoni nga [KPST@kpst.org](mailto:KPST@kpst.org)).

Përmbledhjet Tremujore të Listës së Pagave duhet të dorëzohen në Administratën Tatimore duke përcjellur procedurat e theksuara në Nenet 12, 13 dhe 14 të këtij dokumenti.

Në vijim është modeli Kontributet dhe Libri Tatimor.

## KONTRIBUTET DHE LIBRI TATIMOR

| <b>Viti:</b> _____                              |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
|---|-------------|---|------------|-------------------------|---------------------------------|--------|------------------------|--|--------|----------------------------------|-------------|
| <b>Emri /Mbiemri i të punësuarit</b><br>(_____) |             | <b>NP / NIT i UNMIK-ut i të punësuarit</b><br>_____ |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Muaji   | Pagat bruto | Kontributet pensionale të të punësuarit             |            | Pagat neto para tatimit | Tatimi i të ardhurave personale |        | Pagat neto pas tatimit | Kontributet pensionale të punëdhënësit |        | Totali i kontributeve pensionale |             |
|   |             | Mujore  | Kumulativi |                         | Mujore                          | Mujore |                        | Kumulativi                             | Mujore | Mujore                           | Kumulativi  |
| [a]   | [b]         | [c]   | [d]        | [e]*                    | [f]                             | [g]    | [h]=[e]-[f]            | [i]                                    | [k]    | [m]=[c]+[i]                      | [n]=[d]+[k] |
| Jan.  |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Shk.  |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Mars  |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Prill   |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Maj   |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Qer.  |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Korr.   |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Gush.   |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Shtat.  |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Tet.  |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Nënt.   |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| Dhje.   |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |
| <b>Totali</b>                                   |             |   |            |                         |                                 |        |                        |  |        |                                  |             |

\* Kolona [e] duhet të jetë Pagat Bruto (kolona [b]) minus më pak e kontributit mujor të të punësuarit dhe kontributi mujor nën mandat i të punësuarit (5% e kolonës [b])

Me rëndësi është se për qëllime të Tatimit mbi të Ardhura Personale, vetëm 5% nën mandat e kontributeve të të punësuarit do të jetë e zbritshme. Kontributet vullnetare të të punësuarit që tejkalojnë 5% nuk mund të zbriten nga Pagat Bruto si zbritje e Tatimit mbi të Ardhura.

Kontributi dhe Libri Tatimor do të përfshijnë informatat për secilin të punësuar. Punëdhënësit mund të mbajnë vetëm një komplet të librave dhe regjistrimeve për qëllime të Pensioneve të Kursimeve Individuale dhe për Tatimin mbi të Ardhurat Personale me kusht që ato të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 1/2002 dhe Rregullat e tanishme.

### Neni 7

Obligimi i punëdhënësit të vëzhgojë regjistrimin e të punësuarve për qëllim të pagesave të kontributeve të pensionit

Numri personal i UNMIK-ut sikurse edhe Numri Individual Tatimor (NIT) i lëshuar nga Administrata Tatimore do të shërbejnë si identifikim kryesor i çdo të punësuar individual në sistemin e Pensioneve Të Kursimeve Individuale. Këtë e tutje dorëzimi i informatave që identifikojnë kontribuesin individual është shumë me rëndësi.

Punëdhënësit duhet të sigurohen se të gjithë të punësuarit në emër të të cilëve kontributet pensionale janë paguar, janë të regjistruar ose me Regjistrimin Civil të UNMIK-ut ose me Administratën Tatimore. Regjistrimi në Administratën Tatimore i të punësuarve të cilët nuk mund të sigurojnë një Numër Personal të regjistrimit Civil të UNMIK-ut por të cilët janë të detyruar të paguajnë kontributet pensionale dhe/ose tatimin mbi të ardhura, apo të cilët dëshirojnë të kryejnë kontributet në baza vullnetare do të jetë në përputhje me procedurat e specifikuar nga Administrata Tatimore.

## Neni 8

### Regjistrimet e pidentifikuara

Në qoftë se regjistrimet individuale të të punësuarit – Emri dhe/ose numri personal (NP) – në dokumentet e dorëzuara në Administratën Tatimore apo në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për disa të punësuar janë jo korrekte, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës apo Administrata Tatimore do të ndjek nga afër rastet e tilla së bashku me punëdhënësin. Mund të iniciohet kontrolli.

Nga punëdhënësi do të kërkohet të deklarojë një fletë të Korreksionit të të Dhënave Individuale të siguruar nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Fleta e Korreksionit të të Dhënave Individuale duhet të kthehet nga punëdhënësi mbrenda 3 javëve pas kërkesës nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës apo nga Administrata Tatimore.

## Neni 9

### Çertifikata e Kontributeve të Mbajtura në Burim dhe të Paguara

Secili punëdhënës kërkohet t'i lëshojë secilit të punësuar, në fund të vitit kalendarik, Çertifikatën e Kontributeve të Mbajtura në Burim dhe të Paguara në Pensionet e Kursimeve Individuale në emër të të punësuarit. Format i Çertifikatës është dhënë më poshtë:

## Çertifikata e Kontributeve pensionale nën mandat dhe Tatimi i mbajtur në burim

[1] Emri i punëdhënësit   
[2] Numri i regjistrimit të punëdhënësit   
[3] Adresa e punëdhënësit  [4] Tel:   
[5] Emri i pronarit/drejtorit  [6] Tel:

**Kjo Çertifikatë e Kontributeve pensionale nën mandat dhe Tatimi i mbajtur në burim i të ardhurave personale i është lëshuar të punësuarit pasues:**

[7] Emri i të punësuarit   
[8] NP i UNMIK-ut/Numri individual i tatimpaguesit   
[9] Adresa e të punësuarit  [10] Tel:

Deklaroj se të dhënat e treguara këtu janë të vërteta:

| Periudha tatimore e mbuluar<br>[11] | Të ardhurat bruto<br>[12]         | Kontributi Pensional punëdhënësit (*)<br>[13] | Kontributi Pensional i të punësuarit<br>[14] | Tatimi i mbajtur në burim<br>[15] |
|-------------------------------------|-----------------------------------|---|--|-----------------------------------|
| <input type="text" value="[11]"/>   | <input type="text" value="[12]"/> | <input type="text" value="[13]"/>             | <input type="text" value="[14]"/>            | <input type="text" value="[15]"/> |

Emri, Mbiemri dhe vula e punëdhënësit/Personi i caktuar  
(\_\_\_\_\_)

dd/mm/vv  
\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

(\*) Kontributi pensional i punëdhënësit nuk është as i zbritshëm nga Të Ardhurat Bruto e as nuk përfshihet në të Ardhurat Bruto

### Neni 10

#### Procedurat për pagesën e kontributeve

Kontributet mujore do të dorëzohen në ndonjërin nga bankat e autorizuar të Kosovës. Vlera totale e kontributeve mujore të të punësuarit dhe punëdhënësit, qoftë në formë të transferit nga llogarija bankare e punëdhënësit ose në kesh, duhet të deponohen në llogarinë e specifikuar bankare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Per ta bërë pagesën, të gjithë punëdhënësit kërkohet ta plotësojnë " Pasqyra e Kontributeve për Pension dhe Formulari i Dërgesës " (Seksioni 11 i këtij dokumenti). Formularët e zbrazët do të jenë në dispozicion në deget e bankave të autorizuar regjionale dhe zyrat regjionale të Administratës Tatimore. Formularin mund ta nxjerrni po ashtu në formë elektronike përmes Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (forma e kërkuar: [KPST@kpst.org](mailto:KPST@kpst.org)).

Formularet ne disponim te zyrave regjionale te Administrates Tatimore apo degeve te bankave komerciale do ta kenë numrin serik unik. Formulari i nxjerrur nga software i Trustit të Kursimeve Pensionale te Kosoves nuk do te ketë numer. Kur të procesohen këto forma banka do ta shënoj numrin.

Secili formular me numer serik unik mund te perdoret vetem per nje pagesë te vetme.

Secili punëdhënës duhet ta dorëzojë Pasqyrën e Kontributeve për Pension dhe Formularin i Dërgesës ne kohen e pageses. Formulari duhet te pergaditet ne tri kopje te njejta autentike. Punëtori i bankes duhet t'i nenshkruaj dhe vulos te tri kopjet, te mbaj dy te parat ndersa te treten ia kthen punëdhënsit.

Kopja e punëdhënsit duhet te ruhet per periudhën prej (5) vite.

### Neni 11

Procedura për dorëzimin e Pagesave Plotësuese dhe Plotësimi i Pasqyrës se re te Kontributeve.

Nëse punëdhënësi duhet ta bëj ndonjë pagesë plotësuese te kontributeve per periudhën per te cilën pagesa tashmë është kryer, punëdhënsi duhet ta pergadis nje formular të ri të “Pasqyra e Kontributeve për Pension dhe Formulari i Dërgesës “ dhe ta vendosni pikën kontrolluese në kutinë “Shtesë”. Vetem vlerat shtesë duhet te perfshihet ne kutitë për “Paga bruto për muaj”, “Kontributet e mbajtura ne burim nga të punësuarit “ dhe “Kontributet e Paguara nga Punëdhënësi “;

Pasqyra e Kontributeve për Pension dhe Formulari i Dërgesës është paraqitur më poshtë:



# PASQYRA E KONTRIBUTEVE PËR PENSION DHE FORMULARI I DËRGESËS



[1] Periudha e deklarimit: [1] (MM/VVVV) [2] Numri serik: [2] CM

[3] Numri i regjistrimit të punëdhënësit: [3]

[4] Emri i punëdhënësit [4]

[5] Adresa e punëdhënësit: [5]

[6] Emri i personit kontaktues: [6] Telefoni [6]

[6] Emri i personit kontaktues: [6] Telefoni [6]

Nëse kjo dërgesë është për individ të vetëm, ofroni këto informata:

[7] UNMIK ID / NIT [7]

[8] Lloji i individit:  I vetë-punësuar  Pagesë individuale vullnetare

[9] Vendose një 'X' në kutinë përkatëse nëse nuk ka deklaruar për herë të parë për këtë periudhë deklaruese.  
 Shtesë  Përmirsimi i shënimeve/S'ka pagesë  Pagesa e përmirsuar

[10] Numri i puntorëve: [10]

[11] Bruto të ardhurat për muaj: [11]

[12] Mbjajtja në burim e kontributeve të të punësuarve: [12]

[13] Kontributet e paguara nga punëdhënsi: [13]

[14] Kontributet totale të dërguara [14] = [12] + [13]: [14]

[15] Nëse kutija "Pagesa e përmirsuar" është e shënuar, Totali i transferuar: [15]

**Deklaroj se faktet që i kam paraqitur në këtë pasqyrë janë të vërteta .**

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula

dd/mm/vv

(\_\_\_\_\_)

\_\_/\_\_/\_\_

| Informata për pagesën bankare |  |     |      |       |
|-------------------------------|--|-----|------|-------|
| Numri i llogarisë             | Dega/Referenca e transferit                                    | Nr. | Euro | Vlera |
| 100043011000217               | Mbjajtësi i llogarisë/Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës |     | 500  |       |
|                               |  |     | 200  |       |
| Valuta                        | Shuma  |     | 100  |       |
| Ref. e konsumatorit           | Data e vlefshme  |     | 50   |       |
| Teksti                        |  |     | 20   |       |
|                               |  |     | 10   |       |
|                               |  |     | 5    |       |
|                               |  |     | 2    |       |
|                               |  |     | 1    |       |


## Neni 12

### Raporti I Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës

Secili punëdhënës kërkohet të dorëzojë në zyren regjionale tatimore të Administratës Tatimore, mbrenda 15 ditëve pas përfundimit të tremujorit, Raportin e Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës dhe duhet t'i bashkangjesë asaj Përmbledhjen Tremujore të Listës së Pagave. Formati I formularit Raporti I Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës është dhënë këtu më poshtë:



**RAPORTI I TREMUJORIT PËR  
KONTRIBUTE TË MBAJTURA NË  
BURIM DHE FORMULARI I PAGESËS**



United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

[1] Tremujori:

[2] Numri serik

CQ

[3] Numri i regjistrimit të punëdhënësit:

[4] Emri i punëdhënësit

[5] Adresa e punëdhënësit



Telefoni

[6] Emri i personit të kontaktit

Telefoni

[7] Vendose 'X' nëse nuk ka deklaruar për herë të parë për këtë peruidhë tatimore:  Përmirësimi

[8] Bruto të ardhurat për muaj:

[8]

[9] Kontributet të mbajtura në burim nga të punësuarit gjatë tremujorit:

[9]

[10] Kontributet e paguara nga punëdhënësi në emër të të punësuarve:

[10]

[11] Kontributet totale për tremujorë [11]=9+10:

[11]

[12] Informatat për pagesat mujore dhe të gjithë formularët "Pasqyra e kontributeve dhe dërgesat" të dorzuara gjatë tremujorit:

| Periudha e deklarimit<br>(MM/VVVV)                        | Numri serik në<br>formularin mujor të<br>deklarimit | Emri i bankës | Shuma |
|---|---|---------------|-------|
|   |   |               |       |
|   |   |               |       |
|   |   |               |       |
|   |   |               |       |
|   |   |               |       |
| Shuma totale e kontributeve të paguara në këtë tremujorë: |   |               |       |

Shuma totale e paguar dhe e paraqitur në tabelën e mësipërme duhet të jetë e barabartë me shumën e Kontributeve Totale të paraqitura në kutin [11].

Deklaroj se faktet që i kam paraqitur në këtë raport janë të vërteta.

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe Vula

dd/mm/vv

(\_\_\_\_\_)

\_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

Raporti I Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës mund të merret ne Zyrat regjionale te Administrates Tatimore.

Punëdhënesit mundën poashtu të krijojnë Raportin e Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës si dhe formën Përmbledhja Tremujore e Listës së Pagave ne menyre elektronike duke perdorur software-in e shpërndarë nga Trusti i Kursimeve Pensionale te Kosoves (Kerkoni formen: [KPST@kpst.org](mailto:KPST@kpst.org)).

Dy kopjet e Raportit të Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës do te nënshkruhet nga punëdhënësi. Një kopje, së bashku me Permbledhjen Tremujore të Listës së Pagave, do te mbahen ne Administraten Tatimore, kurse kopja tjeter do te mbahet nga punëdhënësi. Punëdhënësi duhet t'i mbajë letër-kopjet e nenshkruara të të gjitha pasqyrave per periudhën prej së paku pesë (5) viteve.

### Neni 13

#### Dorëzimi I Pasqyrave Tremujore të Përmirësuara

Nese përmirësimet duhet të bëhen në Raportin e Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës që veç është dorëzuar për perioden e dhënë, duhet të dorëzohet formulari i ri. Nese ndryshimet kerkohet te behen vetem ne Raportin e Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës, nuk kërkohet ndonje letër bashkangjitime me kontribute të detajizuara.

Nese përmirësimi perfshinë modifikimet e të dhënave individuale (p.sh. pagat apo kontributet pensionale te paguara gjatë tremujorit per raste specifike te të punësuarve), Përmbledhja e re Tremujore e Listës së Pagave duhet t'i bashkangjitet Raportit të Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës. Përmbledhja Tremujore e Listës së Pagave e re do te perfshijë vetem te dhënat mbi emrin, pagat dhe kontributet e të punësuarve per te cilët jane bere përmirësimet. Poashtu, "Raporti I Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës" do te paraqet shumat totale të përmirësuara mbi pagën dhe kontributet që në të vërtet janë paguar ne tremujor vetem per të punësuarit shenimet e te cilëve kërkojnë përmirësimet.

### Neni 14

#### Dorëzimi i Permbledhjes Tremujore te Listës së Pagave ne formë elektronike. Kushtet e raportimit per punëdhënësit me 50 apo me tepër punëtorë.

Punëdhënësit do te jenë të pajisur me një variant për dorëzimin e Permbledhjes Tremujore te Listës së Pagave ne formë elektronike. Per të pergaditur Permbledhjen Tremujore te Listës së Pagave për dorëzim në formë elektronike, duhet te perdoret software-i I distribuuar nga Trusti I Kursimeve Pensionale te Kosoves (kerko nga: [KPST@kpst.org](mailto:KPST@kpst.org)).

Punëdhënësit qe I përgaditin Permbledhjen Tremujore te Listës së Pagave në emer te 50 apo me teper të punësuarve dhe te cilët nuk e përfillin procedurën e specifikuar ne Nenin 15 duhet ta dorëzojnë Permbledhjen Tremujore te Listës së Pagave ne formatin elektronik, p.sh. me internet (I dergoni [Report@kpst.org](mailto:Report@kpst.org) ) ose ne disketë prej 3 ½ inch ne zyren regjionale te Administrates Tatimore.

Nese dërgohet me internet, Raporti I Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës me numër serik unik do te nxjerret dhe rikthehet tek punëdhënësi permes E-mailit adresës

me të cilën ka ardhur. Ajo pasqyrë duhet te printohet dhe te nënshkruhet nga punëdhënësi, si dhe duhet te dorëzohet tek Zyra Regjionale e Administrates Tatimore.

Nese dorëzohet në disketë tek Zyra Regjionale e Administrates Tatimore, atëherë duhet t'i bashkangjitet forma e printuar dhe e nënshkruar e Raportit të Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari I Pagesës. Administrata Tatimore nuk do t'i kthejë disketat.

Per ndihmë rreth pergaditjes se raporteve tremujore per kontributet individuale për pensione, ju mund te kontaktoni Trustin e Kursimeve Pensionale te Kosovës në; [Report@kpst.org](mailto:Report@kpst.org) .

#### Neni 15

##### Procedura rreth pagimit te kontributeve dhe raportimi ne formë elektronike ne bazë mujore

Punëdhënësit mund te deshirojnë te raportojnë ne formë elektronike për çdo muaj. Punëdhënësit e mëdhenj janë te inkurajuar ta bëjnë këtë qe të minimizojnë mundësinë e gabimeve ne raporte. Punëdhënësit qe raportojnë çdo muaj do te jenë te perjashtuar nga obligimet qe te raportojnë ne bazë tremujore siq është specifikuar me Nenet 12,13,dhe 14 te ketij dokumenti.

Para se ta bëjnë pagesën mujore, punëdhënësit e tillë duhet të marrin nga Administrata Tatimore apo nga Trusti I Kursimeve Pensionale te Kosoves një kopje elektronike te Pasqyra e Kontributeve për Pension dhe Formulari i Dërgesës me numer serik unik. Per të marrë atë pasqyrë elektronike, punëdhënësit duhet te dorëzojnë Regjistrin Mujor të Listës së Pagave ne formë elektronike me internet (te dergohen ne; [Report@kpst.org](mailto:Report@kpst.org) ) apo ne diskete prej 3-1/2 inch tek Zyra e Trustit të Kursimeve Pensionale te Kosoves. Bazuar ne atë dorëzim, Pasqyra e Kontributeve për Pension dhe Formulari i Dërgesës me numer serik unik do te nxirret (gjenerohet) dhe do t'i rikthehet punëdhënësit duke përdorë median e njëjtë. Punëdhënësi do ta përdorë atë Formular të Pasqyrës së Kontributeve për Pensione dhe Pagesë per ta bere pagesën dhe do të deklarojë atë në tri kopje në degët e çdo banke komerciale te autorizuar.

Per të pergaditur Regjistrin Mujor të Listës së Pagave per dorëzim elektronik, duhet te perdorni software-in të distribuuar nga Trusti I Kursimeve Pensionale te Kosoves (forma e kerkuar; [KPST@kpst.org](mailto:KPST@kpst.org))

Per ndihmë në pergaditjen e raporteve mujore elektronike per kontributet pensionale individuale, ju mund te kontaktoni Trustin e Kursimeve Pensionale te Kosoves ne; [Report@kpst.org](mailto:Report@kpst.org) .

Punëdhënësit mund ta fillojnë raportimin në bazë mujore nga data e implementimit te sistemit te pensioneve, apo ne fillim te tremujorit, ose ne fillim te operimit. Deklarimi i pare mujor ne formë elektronike do te tregojë qe punëdhënësi ka zgjedhur dorëzimin për çdo muaj si forme te preferuar te raportimit. Kur metoda e preferuar per raportim është zgjedhur, ajo nuk mund te ndërrohet deri ne mbarim te tremujorit.

#### Neni 16

##### Obligimet e personave te vetë-punësuar lidhur me kontribuimin ne sistemin e kursimeve individuale te pensioneve

Sipas Rregullores mbi Pensionet ne Kosovë, personat e vetë-punësuar do te fillojnë te japin kontribute ne emër te tyre më 1 Mars 2003 përderisa PSSP te vendosë qe ta ndërrojë ate datë. Kontributet vullnetare mund te fillojnë përpara asaj date.

Personat e vetë-punësuar duhet të ndjekin procedurat e njëjta të regjistrimit që kërkojnë nga puntoret tjerë dhe duhet të regjistrohen qoftë me Regjistrin Civil të UNMIK-ut apo të Administratës Tatimore.

Sipas Nenit 32.3(c) të Rregullores mbi Pensionet në Kosovë, nga personat e vetë-punësuar do të kërkojë të kontribuojnë si Punëdhënës dhe si i punësuar. D.m.th., personi i vetë-punësuar duhet të kontribuojë në minimum 10% nga paga bruto.

Çdo person i vetë-punësuar kërkojë të dorëzojë Pasqyrën e Kontributeve për Pension dhe Formularin e Dërgesës. Paga mund të bëhet tek cilado bankë e autorizuar e Kosovës. Personi duhet të vendosë shënjen e kontrollit në kutinë e vetë-punësimit të formularit. Numri personal i UNMIK-ut dhe Numri Tatimor Individual poashtu duhet të specifikohen.

Formulari i Pasqyrës së Kontributeve për Pensione dhe Pagesë do të përgaditet në tri kopje origjinale. Sportelisti i bankës do ta nënshkruajë dhe do t'i vulosë të tri kopjet, i mbanë dy kopjet e para kurse të tretën ia kthen kontribuesit.

Personat e vetë-punësuar nuk kërkojë të deklarojnë Raportin e Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formularin e Pagesës.

#### Neni 18

##### Pagat e paguara në natyrë

Kur të ardhurat paguhen në natyrë, punëdhënësi dhe i punësuar janë të obliguar të paguajnë nga 5% secili të vlerës së hapur të tregut të mallrave dhe/apo shërbimeve të paguara për të punësuarin si shkëmbim për shërbimet e kryera nga i punësuar. Nëse vlera e hapur e tregut për mallrat dhe/apo shërbimet të paguara për të punësuarin është më e ulët sesa paga minimale, kontributet do të jenë 5% të pages minimale nga secili, nga punëdhënësi dhe i punësuar. Si shembull, një i punësuar i punishtës së verës 'X' është paguar në natyrë për muajin maj 2002 meqë punëdhënësi ka mungesë parash të gatshme (kesh). Punëtori merr 80 litra verë. Vlera e mallit në treg për atë artikull të verës është 4 €/litër. Paga mujore e të punësuarit për atë muaj do të jetë  $80 \times 4 = 320$  € Kontributi i të punësuarit dhe punëdhënësit për atë muaj do të jetë 16 € për secilin apo 32 € gjithsej.

#### Neni 19

##### Paga më e Vogël se Paga Minimale

Paga minimale për qëllime të kontributeve do të jepet më vonë, por të supozojmë se ai ka qenë e fiksuar në 50€ për muaj. Nëse punëdhënësi 'X' e paguan të punësuarin AB vetëm 40€ në muaj, punëdhënësi 'X' do të duhet të llogarisë kontributet e AB-s dhe kontributet e tija personale të bazuar në pagën minimale prej 50 €

#### Neni 20

##### Kontributet Individuale dhe Partecipimi Vullnetar

Individët që nuk janë subjekt i participimit nën mandat në sistemin e Kursimeve Individuale Pensionale të bazuara në statusin e moshës, statusin e qëndrimit, ose në statusin e punëdhënësit, mund të zgjedhin kontributin vullnetar për Kursimet Individuale Pensionale.

Individët që japin kontribute në bazë vullnetare nuk janë subjekt i kërkesave (kushteve) të përqindjes minimale të kërkuara dhe nuk janë të obliguar të paguajnë kontributet e punëdhënësit. Megjithatë kontributi minimal vullnetar mund të mos jete më pak se 5% i pagës minimale (Neni 19 i këtij

dokumenti), si dhe shuma maksimale e kontributit mund të mos e tejkaloj 15% te kontributit të të punësuarit plus 15% të kontributit të punëdhënësit

Te gjithë kontribuesit vullnetar duhet të jene të regjistruar në Regjistrin Civil të UNMIK ose në Administratën Tatimore. Të punësuarit të cilet nuk mund të marrin numrin personal të UNMIK-ut duhet të aplikojnë të regjistrohen në Administratën Tatimore, në përputhje me udhëzimet e leshuara nga Administrata Tatimore.

Secili kontribues vullnetar do të dorëzojë ” Pasqyrën e Kontributeve për Pension dhe Formularin e Dërgesës “ në kohën e pagesës në ndonjërin nga bankat e autorizuara në Kosovë. Kontribuesi vullnetar duhet të vendosë shenjen kontrolluse në kutinë e pagesës individuale vullnetare të formularit. Numri personal i UNMIK-ut ose Numri Individual Tatimor duhet gjithashtu të specifikohet.

Pasqyra e Kontributeve për Pension dhe Formulari i Dërgesës do të jete i përgatitur në tri kopje origjinale. Punetori i bankës duhet t’i nënshkruaj dhe vulosë të tri kopjet, i mbanë dy të parat, dhe i kthen kopjen e tretë kontribuesit.

Nga kontribuesit individual vullnetar nuk kërkohet që të deklarojnë Raportin e Tremujorit për Kontributet e Mbajtura në Burim dhe Formulari i Pagesës.

#### Neni 21

##### Punëdhësit të cilet kontribuojnë vullnetarisht

Nese ndonjë punëdhënës i cili ndryshe nuk është nën mandat të paguaj kontributet pensionale dëshiron që ta bëjë pagesën vullnetare në emër të të punësuarve, ai/ajo duhet ta përcjell pagesën dhe procedurën e raportimit njëjtë sikurse për punëdhënësit e tjerë. Pagesat vullnetare nga punëdhënësit e tillë nuk do të jenë subjekt i kërkesave të përqindjes minimale. Megjithatë kontributi minimal qoftë i punëdhënësit ose i të punësuarit mundet të mos jetë më pak se 5% e pagesës minimale (neni 19 i këtij dokumenti ) dhe kontributi maksimal mundet të mos tejkaloj 15% të pagesës së të punësuarit për kontributet e të punësuarit dhe 15% të pagesës së të punësuarit për kontributet e punëdhënësit .

#### Neni 22

##### Si të kontaktoni Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

Punëdhënësit të cilet dëshirojnë të kontaktojnë Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për ndonjë kërkesë, pyetje, apo informata mund ta bëjnë duke dërguar e-mail-in në [KPST@kpst.org](mailto:KPST@kpst.org). Pyetjet dhe kërkesat duhet të jenë të parashtruar qartë. Informatat në vazhdim duhet të sillen si pjesë e kërkesës: emri i organizatës, titulli /pozita dhe informatat kontaktuese.

#### Neni 23

##### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi me datën \_\_\_\_\_2002

Andree NADEAU

Mustafë HASANI

Bashkë-Drejtoreshë e Administratës Tatimore

Bashkë-Drejtor i Administratës Tatimore